

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR**

**Data: 28.10.2019**

**Për: Bashkimi i operatoreve ekonomike “I.D.K Konstruksion”Sh.p.k K51408016J & “4 A-M” Sh.p.k, K92005016L.** Adresa: Rruga “Zaja”, Kodër Bërxulle, 1032, Vorë, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur/Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”.

Numri i referencës së procedurës: **REF-34666-08-30-2019.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Përmirësimi i sigurisë rrugore”.**

Kohëzgjatja: **20 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomike “Alko Impex General Construction” sh.p.k NIPT K91326028I dhe “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k NIPT L62228020U.  
Vlera e ofertës 182,725,650 (njëqind e tetëdhjetë e dy milion e shtatëqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH
2. Bashkimi i operatoreve ekonomike “Jubica” sh.p.k NIPT K26529001I dhe “Meteo” sh.p.k NIPT L26310801C. Vlera e ofertës 195,000,000 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë milion) lekë pa TVSH.
3. Bashkimi i operatoreve ekonomike “I.D.K Konstruksion” sh.p.k NIPT K51408016J dhe “4 A-M” sh.p.k NIPT K92005016L. Vlera e ofertës 229,818,537 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë ) lekë pa TVSH.

Janë s’kualifikuar ofertuesit:

Për arsyet e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomike “Alko Impex General Construction” sh.p.k NIPT

K91326028I dhe “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k NIPT L62228020U. Operatori ekonomik “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k, pjesetar i bashkimit te operatoreve ekonomike “Alko Impex General Construction” sh.p.k dhe “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k nuk ploteson kriterin 2.2.1 te Kritereve te veçanta të kualifikimit, per sa i perket xhiros mesatare te realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit 2016, 2017 dhe 2018, sipas percaktimeve te nenit 74, pika 3 e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i rishikuar, ku percaktohet se kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” sh.p.k pjesetar i bashkimit te operatoreve ekonomike “Alko Impex General Construction” sh.p.k dhe “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k nuk ploteson kriterin 2.3.1 te Kritereve te veçanta të kualifikimit per sa i perket pervojës se meparshme te ngjashme, sipas percaktimeve te nenit 74, pika 3 e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i rishikuar, ku percaktohet se kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” sh.p.k ka paraqitur nje kontrate te ngjashme per “Mirembajtje bazuar ne performace te segmenteve rrugore” e cila jo vetem nuk ka ngjashmeri ne natyren e punimeve, kompleksitetin, metodologjine, etj por nuk ploteson vleren e kerkuar sipas perqindjes as per kushtin 2.3.1/a apo 2.3.1/b.

Operatori ekonomik “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k pjesetar i bashkimit te operatoreve ekonomike “Alko Impex General Construction” sh.p.k dhe “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k nuk ploteson kriterin 2.3.2 te Kritereve te veçanta të kualifikimit per sa i perket punësimit mesatar të punonjësve për periudhën Janar 2019 – Korrik 2019, sipas percaktimeve te nenit 74, pika 3 e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i rishikuar, ku percaktohet se kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje. Sipas perqindjes se përcaktuar në akt marrëveshje operatori ekonomik “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k duhet te plotesoje nje numer punetoresh disa here me te larte se numri i paraqitur.

2. Bashkimi i operatoreve ekonomike “Jubica” sh.p.k NIPT K26529001I dhe “Meteo” sh.p.k NIPT L26310801C. Operatori Ekonomik “Jubica sh.p.k, eshte terhequr nga procedura e prokurimit perpara fazes se vleresimit me ane të nje kerkese te paraqitur zyrtarisht prane Fondit Shqiptar te Zhvillimit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimi i operatoreve ekonomike **“I.D.K Konstruktion”Sh.p.k & “4A-M” Sh.p.k** me adresë Rruga “Zaja”, Kodër Bërxulle, 1032, Vorë, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **229,818,537 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë ) lekë**

pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 42 235 597/8 (int. 151)**
- **Fax: 00355 42 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brënda pesë ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do të anulohet, siç parashikohet në nenin 24 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **16.10.2019.**

Afatet e ankimimit kanë përfunduar dhe për procedurën nuk janë paraqitur ankesa.

**Dritan AGOLLI**

**Drejtori Ekzekutiv**